

Stadtdekan Msgr. Dr. Hermes · Königstraße 7 · 70173 Stuttgart

**Misioneve/komuniteteve për Katolikët  
të gjuhëve të tjera amtare në Shtutgart**

Monsignore  
**Dr. Christian Hermes**

Königstraße 7  
70173 Stuttgart

T 0711 70 50-510  
F 0711 70 50-501  
stadtdekan.stuttgart@drs.de  
katholische-kirche-stuttgart.de

Shkurt 2024

**Ne qëndrojmë së bashku kundër ksenofobisë!**

**Letër katolikëve që flasin një gjuhë tjetër amtare në dekanatin e qytetit të Shtutgartit**

Të dashur vëllezër dhe motra,

Javëve të fundit, qindra mijëra njerëz kanë dalë në rrugë anembanë Gjermanisë në demonstrata për të ngritur zërin e tyre kundër ksenofobisë /*dmth. armiqësisë ndaj të hujave*/ dhe lëvizjeve fashiste e nacionaliste. I kam kritikuar vazhdimisht lëvizje të tilla të rrezikshme. Me kënaqësi po ju vë në dispozicion tekstin e fjalimit tim në një nga këto demonstrata në Schlossplatz në Shtutgart më 27 janar 2024.

Meqenëse e di që ju, si njerëz "me prejardhje migrimi" (siç thonë autoritetet), jeni veçanërisht të lënduar nga tendencat ksenofobike dhe jeni të shqetësuar se çfarë do të ndodhë më pas në Gjermani, po ju shkruaj këtë letër. Para së gjithash, një gjë është e rëndësishme për mua: Si Kishë Katolike, ne jemi një kishë botërore, një kishë brenda dhe nga të gjithë popujt, motra dhe vëllezër! Në festën e Rrëshajëve, dallimi midis popujve dhe gjuhëve kapërcehet në Shpirtin e Hyjit (Veprat 2,1-13), është dallimi që ndan dhe të çon në armiqësi. Pali thekson se "Nuk ka më hebre - grek! Nuk ka më: skllav - i lirë! Nuk ka më: mashkull - femër! Të gjithë ju jeni NJË në Krishtin Jezus!" (Galatasve 3,28).

Kjo është arsyeja pse ekziston vetëm një kishë "katolike", domethënë një kishë gjithëpërfshirëse, e cila është thirrur të veprojë si tharmi në një familje njerëzore. Nuk ka "kishë kombëtare", "gjermane" apo "italiane" apo "kishë kroate". Ekziston vetëm një kishë katolike në vende dhe kultura të ndryshme. Në vend të besimit të krishterë, nacionalizmi sapo ka filluar ta kthejë adhurimin e nacionit /kombit/ të vet në një fe zëvendësuese në të cilën një popull ngrihet mbi të tjerët. Racizmi dhe fashizmi shpik "raca" njerëzish sikur të ishim ne qen apo mace, vetëm për të përdorur kulturën e dikujt, ngjyrën e lëkurës së dikujt apo ndonjë karakteristikë tjetër për të diskriminuar të tjerët. Ideologji të tilla të qortueshme janë të papajtueshme me krishterimin!



Besimi themelor katolik se Kisha u përket të gjithë popujve është i lidhur me besimin themelor në dinjitetin që Zoti i ka dhënë çdo personi dhe që për këtë arsye nuk varet nga asnjë autoritet politik ose mund t'u jepet ose hiqet njerëzve. Filozofi i rëndësishëm dhe biri i Shtutgartit Georg Wilhelm Friedrich Hegel pat thënë rreth 200 vjet më parë: "Njeriu konsiderohet i tillë sepse është njeri, jo sepse është hebre, katolik, protestant, gjerman, italian e kështu me radhë." Kjo nuk është asgjë tjetër, por bindje e krishterë për dinjitetin njerëzor. Kjo bindje është e shënuar në nenin e parë të Ligjit Themelor, Kushtetutës së Republikës Federale të Gjermanisë: "Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm. Respektimi dhe mbrojtja e tyre është obligim i të gjithë pushtetit shtetëror." (Neni 1 paragrafi 1 Ligji Bazë) Menjëherë më pas thotë: "Askush nuk lejohet të pafavorizohet ose të favorizohet për shkak të gjinisë, prejardhjes, racës, gjuhës, atdheut dhe origjinës së vet, besimit të vet, pikëpamjeve të veta fetare ose politike." (Neni 3 Para. 3 Ligji Bazë) Ju mund të mbështeteni në faktin se kjo kushtetutë shtetërore është e fortë dhe do të mbrohet kundër armiqve të saja.

Fatkeqësisht, në Gjermani ka njerëz që kanë paragjyqime dhe mospëlqime ndaj të huajve. Si në shumë vende, ka nacionalistë, racistë, fashistë, antisemitë, armiq të demokracisë, armiq të fesë apo të kushtetutës sonë. Viteve të fundit, njerëzit janë radikalizuar, edhe nëpërmjet "mediave sociale", të cilat për fat të keq shpesh janë më shumë si "media antisociale". Krizat dhe problemet e shumta shqetësojnë shumë njerëz. Disa janë edhe infantilë edhe të rrezikshëm, sepse në zhgënjimin dhe zemërimin e tyre humbasin mendjen, duan zgjidhje të thjeshta dhe kërkojnë njerëz për të fajësuar dhe për t'i bërë kurban sakrifice. Bashkëqytetarët tanë hebrej janë veçanërisht të prekur nga kjo, por urrejtja mund të drejtohet shpejt edhe te të tjerët. Disa nga këta budallenj besojnë se nëse "Gjermania do t'u përkiste Gjermanëve", të gjitha problemet do të zgjidheshin.

Ide të tilla të rrezikshme kanë ekzistuar gjithmonë dhe, duhet të druajmë, se gjithmonë do të ketë. Megjithatë, vitet e fundit kemi parë se si këto lëvizje kanë arritur të tërheqin vëmendjen me sloganet e tyre ksenofobike dhe mesazhet e urrejtjes. Me "AfD", të ashtuquajturën "Alternativa për Gjermaninë", është krijuar një lëvizje politike që nuk ofron zgjidhje për problemet ekzistuese, por vetëm përhap urrejtje dhe ngacmime. Kjo parti fashiste dhe antidemokratike, pjesërisht e djathtë ekstremiste dhe ksenofobike është e përfshirë në rrjete që mbrojnë deportimin e njerëzve që, sipas tyre, nuk janë Gjermanë "të vërtetë".

Ju, të dashur motra dhe vëllezër që flisni gjuhë të tjera amtare, nuk keni pse të shqetësoheni se një shumicë në këtë vend ndjek ideologji të tilla të rrezikshme. Përkundrazi: jo vetëm në kishën tonë, por edhe në Shtutgart, në Baden-Vyrtemberg dhe në mbarë Gjermaninë, shumica e qartë nuk është ksenofobike. Sidomos këtu në qytetin tonë, ku jetojnë njerëz nga gati 160 nacionalitete/kombe, vlen ajo që tha një ish-kryetar bashkie: "Kushdo që jeton në Shtutgart është Shtutgartas!" Ata janë shumë të respektuar si bashkëqytetarë! Të gjithë ata që jetojnë këtu dhe që e respektojnë ligjin janë pjesë e tij! Ju, të dashur motra dhe vëllezër, jeni 100 për qind pjesë e tij!

Tendencat jo vetëm ksenofobike por edhe antinjerëzore bien në kundërshtim të qartë me kushtetutën gjermane. Kjo është arsyeja pse shumë po bëjnë thirrje që partitë si "AfD" të ndalohen. Në çdo rast, ato bien ndesh me parimet themelore të besimit të krishterë dhe katolik. Askush nuk duhet të mashtrohet sepse këto lëvizje e paraqesin veten si "konservatore" apo "tradicionale" ose pretendojnë se po mbrojnë "Perëndimin e krishterë" apo se janë miqtë tanë. Kam shumë vite që e shikoj "AfD"-në: kjo parti është bërë gjithnjë e më ekstreme, gjithnjë e më e rrezikshme. Pasi këta njerëz e kuptuan se kishat dhe ipeshkëvinjtë në Gjermani ishin shprehur qartë kundër tyre, ata treguan fytyrën e tyre të



vërtetë: Ata nuk janë vetëm armiq të të gjithë njerëzve të huaj, të cilët duan t'i tolerojnë vetëm nëse asimilohen plotësisht, por ata janë edhe armiq të krishterimit dhe armiq të Kishës! Konferenca e Ipeshkvijve të Gjermanë dha së fundmi një deklaratë unanime dhe të qartë për këtë (<https://www.drs.de/ansicht/artikel/fuer-menschenwuerde-und-die-freiheitliche-grundordnung.html> ).

Si dekan i qytetit, dua t'ju siguroj se ne, si katolikë nga të gjitha nacionalitetet/kombet, qëndrojmë së bashku këtu në Shtutgart dhe se unë, së bashku me klerin dhe besimtarët e kishës sonë, do të qëndroj gjithmonë për ju kur tendenca të tilla ksenofobike dhe zëra të tillë të mizantropisë përpiqen të përhapin propagandën e tyre!

Tashmë kemi filluar të publikojmë një fushatë në rrjete me titull "Ne jemi një kishë globale, Jo ksenofobisë!" Unë do t'ju kërkoja të merrni pjesë në të. Është e rëndësishme që të jemi të dukshëm dhe të dëgjueshëm, të mos lejojmë që të frikësohemi apo fshihemi, por katolikëve që kanë gjuhë amtare gjermanishten dhe atyre me gjuhë të tjera amtare t'u japim një shembull të mirë të sinqeritetit, guximit dhe kohezionit politik e fetar. Ju lutem informohuni edhe për zhvillimet politike, partitë dhe programet. Merrni përgjegjësi jashtë kishës në shoqërinë civile! Nëse keni të drejtë vote, merrni pjesë në zgjedhje!

Këtu janë disa këshilla: Në **zgjedhjet lokale** (me përjashtim të zgjedhjeve për asamblenë rajonale të Lidhjes së Rajonit të Shtutgartit), qytetarët e BE-së që janë të paktën 16 vjeç dhe kanë pasur vendbanimin e tyre kryesor në Shtutgart për të paktën tre muaj më parë, të drejtë vote kanë edhe datën e zgjedhjeve më 9 qershor 2024. Kjo do të thotë se ky grup personash do të përfshihen në regjistrin e zgjedhësve në bazë të regjistrimit të tyre në zyrën e regjistrimit të banorëve/zyrës së qytetarëve dhe do të marrin njoftimin zgjedhor në kohën e duhur. Ka edhe raste të jashtëzakonshme, në të cilin rast mund të ketë kuptim të kontaktoni drejtpërdrejt administratën e qytetit (Zyrën e Statistikave, [www.stuttgart.de/organigramm/verwaltungsunite/statistisches-amt.php](http://www.stuttgart.de/organigramm/verwaltungsunite/statistisches-amt.php) ).

Në **zgjedhjet evropiane**, qytetarët e BE-së mund të regjistrohen në regjistrin e votuesve të qytetit të Shtutgartit nëse janë të paktën 16 vjeç dhe plotësojnë kushte të tjera. Zyra e Statistikave gjatë muajit mars dëshiron t'u shkruajë të gjithë qytetarëve të prekur dhe të regjistruar të BE-së dhe t'i informojë ata për opsionin e aplikimit. Nëse një person në Gjermani është i regjistruar në listën zgjedhore për zgjedhjet evropiane, ai nuk mund të marrë pjesë në zgjedhjet e BE-së në vendin e kombësisë së vet. Gjithashtu zbatohen rregullat gjermane për votim dhe moshë minimale 16 vjeç. Çdo vend i BE-së ka rregulloret e veta për votën dhe moshën për të votuar, prandaj aplikimi për hyrje në listën zgjedhore mund të jetë interesant për disa qytetarë të BE-së për shkak të këtyre ndryshimeve në rregullore.

Të gjithë së bashku, katolikë, të krishterë dhe fe të tjera, demokratë dhe të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, do të mposhtim forcat shkatërruese që shkaktojnë urrejtje dhe përçarje!

Të bashkuar në Krishtin, ju përsëndes ngrohtësisht!

I juaji Monsinjon Dr. Christian Hermes  
Dekani i qytetit të Shtutgartit

